

**Vendim nr. 42, datë 26.03.2026**

**(V- 42/26)**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sandër Beci, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 26.03.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (E) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:**                   **ERMAND MUÇA**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**GËZIM MUÇA**

**OBJEKTI:**                   **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-162, datë 22.01.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

**GJYKATA KUSHTETUESE**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Ermand Muça (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me

shkrim të subjektit të interesuar, Gëzim Muça, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është trashëgimtar i Halim Muçës, i cili së bashku me Xheladin Muçën kanë qenë fëmijë të Ajaz dhe Hajrije Muçës. Këta të fundit kanë pasur në pronësi një banesë të ndodhur në qytetin e Durrësit me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>, si dhe truallin me sipërfaqe 315.2 m<sup>2</sup> mbi të cilin ajo ndodhej. Xheladin Muça ka ndërruar jetë në vitin 1982, ndërsa në vitin 1983 ka ndërruar jetë edhe i ati Ajaz Muça. Me vendimin e datës 10.09.2002 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka përcaktuar si trashëgimtarë të radhës së parë të Ajaz Muçës bashkëshorten e tij Hajrije Muçën e djalin Halim Muçën, të cilët kanë trashëguar nga 3/9-ën pjesë të pasurisë secili, si dhe fëmijët e Xheladin Muçës, konkretisht subjektin e interesuar në këtë gjykim, Gëzim Muçën, dhe motrat e tij Shpresa Ademi dhe Shazie Kokaj, të cilat kanë trashëguar nga 1/9-ën pjesë të pasurisë secili.

2. Me kontratën e dhurimit të datës 19.06.1993 Hajrije Muça i ka dhuruar nipit të saj Gëzim Muça banesën me sipërfaqe 94 m<sup>2</sup>. Më pas, me kontratën noteriale të datës 08.07.2004, kjo shtetase dhe shtetaset Shpresa Ademi e Shazie Kokaj i kanë shitur Gëzim Muçës pjesët e tyre takuese të truallit që kishin në bashkëpronësi me Halim Muçën, mbi të cilin ndodhej banesa. Trualli është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurisë (ZVRPP), Durrës në datën 26.09.2014, në pronësi të Gëzim Muçës e Halim Muçës, respektivisht me 6/9-ën dhe 3/9-ën pjesë secili, si dhe me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>.

3. Në datën 20.06.2014 Gëzim Muça i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi për pjesëtimin e truallit, duke pretenduar se banesa e dhuruar nga gjyshja kishte qenë e vjetër dhe në vend të saj kishte ndërtuar një banesë të re, për të cilën kishte marrë disa herë kredi bankare dhe kishte nisur procedurat e legalizimit. Kjo banesë shtrihej në të gjithë sipërfaqen e truallit dhe për ndërtimin e saj bashkëpronari tjetër Halim Muça (xhaxhai) nuk kishte pasur pretendime. Në këtë situatë, trualli duhej t'i lihej atij kundrejt shpërblimit të Halim Muçës për pjesën takuese të tij.

4. Në kushtet kur palët nuk kanë pasur kundërshtime, në përfundim të gjyqimit të fazës së parë të pjesëtimit, gjykata ka lejuar pjesëtimin e pasurisë, sipas pjesëve takuese: Gëzim Muça 6/9-ën e saj dhe Halim Muça 3/9-ën e saj, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Ndërsa në përfundim të fazës së dytë të pjesëtimit, me vendimin nr. (11-2015-1400) 533, datë

26.03.2015, të ndrequr me vendimin nr. (11-2016-4948) 158, datë 04.11.2016, gjykata ka vendosur kalimin e pasurisë në pronësi të Gëzim Muçës dhe detyrimin e këtij shtetasi t'i paguajë Halim Muçës vlerën për pjesën e tij takuese (1/3-ën) në shumën 1.800.000 lekë, brenda afatit 6-mujor pasi ky vendim të marrë formë të prerë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Halim Muça, duke pretenduar, ndër të tjera, se ndërtimi ishte bërë pa miratimin e tij, ndërsa Gëzim Muça ka paraqitur kundërapel, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit.

5. Me vendimin nr. 10-2016-1260 (549), datë 07.06.2016, Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë të drejtë dhe të bazuar në ligj e në prova. Halim Muça ka ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi në datën 06.07.2016, ndërsa ka ndërruar jetë në datën 16.04.2020. Në datën 18.06.2020 trashëgimtarët e tjera të këtij shtetasi kanë hequr dorë nga pjesa e trashëgimisë së tyre në favor të kërkuesit. Kurse në datën 06.03.2017 ZVRPP-ja, Durrës ka regjistruar pasurinë objekt gjykimi në emër të Gëzim Muçës, duke e pasqyruar atë me sipërfaqe 310 m<sup>2</sup>, nga të cilat 273 m<sup>2</sup> ndërtesë, dhe në datën 16.09.2020 ka lëshuar në emër të tij certifikatën për vërtetimin e pronësisë. Po kështu, në datën 13.12.2024, subjekti i interesuar, Gëzim Muça, ka njoftuar Gjykatën e Lartë për këtë regjistrim, si dhe ka kërkuar përshpejtimin e gjykimit të çështjes.

6. Me vendimin nr. 00-2025-162, datë 22.01.2025, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të Halim Muçës, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

7. Në datën 12.05.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 20.05.2025. Më pas, në datën 16.07.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë:

i) zbatimin e gabuar dhe mosreferimin e përmbajtjes së plotë të nenit 207, paragrafi 3, të Kodit Civil (*KC*) nga gjykatat më të ulëta, konkretisht të togfjalëshit “i cili kërkon pjesëtimin” në këtë dispozitë, si dhe nuk u ka dhënë

- përgjigje pretendimeve të tij në këtë drejtim, në cenim edhe të *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj*; ii) jurisprudencën e saj unifikuese ose rendin hierarkik të KC-së në raport me parashikimet e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar (*Ligji për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje*).
- 8.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi shqyrtimi i rekursit është bërë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit.
- 8.1.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë mundësinë të shprehej e të dëgjohej për zbatimin e nenit 207, paragrafi i tretë, të KC-së, në cenim edhe të nenit 473/a të KPC-së.
- 8.1.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh pretendimet e parashtruara prej tij në rekurs, të cilat përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.
- 8.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi, ndonëse i ka cituar në vendim, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve konkrete të ngritura prej tij në rekurs dhe nuk ka arsyetuar se përse ato nuk përfshiheshin në parashikimet e nenit 472 të KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit.
- 8.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë e ka vendosur në kushte pabarazie me shtetasin Gëzim Muça, si për sa u përket të ardhurave të përfituara nga ky i fundit përmes veprimtarisë së ushtruar në përdorim të sendit, ashtu edhe vlerës së akorduar për truallin.
- 8.3. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në lidhje me *parimin e sigurisë juridike*, pasi sipërfaqja e truallit objekt gjykimi ishte efektivisht e pjesëtueshme në natyrë. Gjykata e Lartë ka lejuar transformimin e kuptimit të nenit 207, paragrafi i tretë, të KC-së, në interpretim të gabuar të qëllimit të ligjvënësisë. Sipas këtij neni, ai që duhej kompensuar ishte paditësi dhe jo i padituri. Po kështu, kjo gjykatë ka lejuar zbatimin nga gjykatat e faktit të Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje, të miratuar me shumicë të thjeshtë votash, ndërkohë që duhet të kishte marrë parasysh dispozitat e KC-së, i cili qëndronte në një rang më të lartë hierarkik. Ndërtimi pa leje në një sipërfaqe në bashkëpronësi nuk presupozon eliminimin e bashkëpronësisë.

8.4. *Parimi i proporcionalitetit*, pasi referuar të dhënave të agjencive imobiliare, vlera e truallit, duke llogaritur edhe vlerën që ai merr pas ndërtimit në të, arrin në 700 euro/m<sup>2</sup> për apartamentet ose pallatet që ndërtohen dhe mbi 2.000 euro/m<sup>2</sup> për dyqanet.

9. **Subjekti i interesuar, Gëzim Muça**, ka prapësuar:

9.1. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *parimit të sigurisë juridike e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj* kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin nga gjykatat e zakonshme të nenit 207, paragrafi i tretë, të KC-së, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues. Për më tepër, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, kjo dispozitë është zbatuar drejt nga gjykatat, pasi trualli ishte i bashkuar me banesën e ndërtuar në të, duke formuar një send të vetëm, i cili nuk mund të ndahej. Edhe pretendimet për rendin hierarkik të Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje në raport me parashikimet e KC-së janë të pabazuara, pasi gjykatat kanë zbatuar dispozitat e KC-së, duke mbajtur në konsideratë të drejtat që ai përfitonte sipas Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje.

9.2. Pretendimet për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar* janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë nuk ka vënë në diskutim çështje të ligjit, ndaj nuk kishte vend për zbatimin e nenit 473/a të KPC-së.

9.3. Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit* janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka ushtruar lirisht të gjitha të drejtat e tij si palë në gjykim.

9.4. Pretendimet për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi kërkuesi ka marrë përgjigje të arsytuara nga gjykatat e faktit, ndërsa arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë për vendimet e mospranimin të rekursit është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese.

9.5. Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, të cilat parashtrohen në drejtim të zbatimit të nenit 207, paragrafi i tretë, të KC-së, janë gjithashtu të pabazuara.

9.6. Pretendimet për cenimin e *së drejtës së pronës dhe hierarkisë së akteve* janë të pabazuara, pasi trualli nuk ka qenë asnjëherë i lirë. Në të ka qenë ndërtuar banesë ku ai ka jetuar me prindërit e gjyshen, ndërsa Halim Muça është larguar nga banesa në vitin 1968, duke përfituar shtëpi nga shteti. Po kështu, Ligji për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje ka njohur kufizimin e së drejtës së pronës, duke

e shtrirë atë edhe mbi mjetet juridike të mbrojtjes së saj, si dhe të drejtën e kompensimit të pronarëve që preken nga ndërtimet pa leje. Ky ligj i është nënshtruar edhe vlerësimi të Gjykatës, e cila ka pranuar se ai ndjek një interes publik. Tashmë objekti është legalizuar, pasi përmbushte kriteret e ligjit.

9.7. Pretendimet për cenimin e *parimit të proporcionalitetit* jo vetëm që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, konkretisht të aktit të ekspertimit të bërë në gjykim nga eksperti, por janë edhe të pabazuara. Kërkuesi ka qenë dakord me aktin e ekspertimit e nuk ka pasur kundërshtime për të. Prona e kërkuesit iu është nënshtruar rregullave të KC-së për pjesëtimin e sendit të paluajtshëm. Vlera për pjesën e pasurisë së tij është përcaktuar nga eksperti bazuar në vlerën e tregut në kohën e gjykimit dhe është njohur nga gjykata. Kjo vlerë i është paguar kërkuesit në momentin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, përmes llogarisë së shërbimit përmbartimor. Ndërkohë, krahas kësaj vlere, kërkuesi ka përfituar edhe kompensim nga legalizimi i banesës sipas Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje, duke përfituar për pasurinë objekt gjykimi më shumë se çka i takonte.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, pasi është trashëgimtar ligjor i shtetasit Halim Muça, i cili ka qenë palë në gjykimin për të cilën është dhënë vendimi gjyqësor objekt kundërshtimi në Gjykatë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon që, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, kërkuesi duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe në substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit*, duke parashtruar në thelb se është vendosur në kushte pabarazie me shtetasin Gëzim Muça, si për sa u përket të ardhurave të përfituara nga ky i fundit përmes veprimtarisë së ushtruar në përdorimin e sendit, ashtu edhe vlerës së ulët që gjykatat i kanë akorduar për truallin, e cila, sipas tij, në fakt është shumë herë më e lartë. Për sa u përket këtyre pretendimeve, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se ato nuk janë parashtruar më parë në gjykatat e zakonshme. Kështu, gjatë gjykimit të zhvilluar në gjykatat e faktit trashëgimlënësi i kërkuetit, Halim Muça, ka kërkuar kthimin fizik të pjesës së tij të truallit, ndërsa nuk rezulton të ketë ngritur pretendime për vlerën e akorduar për të ose të ardhurat e përfituara nga Gëzim Muça në përdorimin e sendit. Në kushtet kur kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këto pretendime, Gjykata vlerëson se ato nuk mund të merren në shqyrtim. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkuesi i ka parashtruar në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme, duke shteruar mjetet juridike efektive për to, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

14. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor civil mban datën 22.01.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 12.05.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae* kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e zakonshme i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor* (në aspekt të *parimit të sigurisë juridike të lidhur me të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit, së drejtës për t’u dëgjuar, parimit të barazisë së armëve e të kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*), si dhe *të drejtën e pronës*

të lidhur me *parimin e sigurisë juridike*, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 4, 142, pika 1, dhe 41 të Kushtetutës.

16. Për sa u përket këtyre pretendimeve, duke mbajtur në konsideratë argumentet në thelb të tyre, të cilat kanë të bëjë me mosdhënien përgjigje nga Gjykata e Lartë të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat më të ulëta, si dhe rolin dhe funksionin e Gjykatës së Lartë në verifikimin e respektimit të standardeve kushtetuese, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim të së drejtës *së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*.

#### *B. Për themelin e pretendimeve*

*B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

17. Kërkuesi ka pretenduar se, duke e shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë mundësinë të shprehet për ligjin e zbatueshëm e nuk ka marrë në konsideratë pretendimet e tij se gjykatat e faktit nuk kanë referuar saktë dhe nuk kanë respektuar nenin 207, paragrafi i tretë, të KC-së, sipas të cilit ai që duhej kompensuar ishte paditësi dhe jo i padituri, duke transformuar edhe ajo kuptimin e kësaj dispozite, në interpretim të gabuar të qëllimit të ligjvënësit e në shkelje të nenit 473/a të KPC-së. Po sipas tij, Gjykata e Lartë ka lejuar zbatimin nga gjykatat e faktit të Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje, të miratuar me shumicë të thjeshtë votash, ndërkohë që duhet të kishte marrë parasysh dispozitat e KC-së, i cili qëndronte në një rang më të lartë hierarkik. Edhe pse i ka cituar në vendim, ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura prej tij në rekurs dhe nuk ka arsyetuar se përse ato nuk përfshiheshin në parashikimet e nenit 472 të KPC-së, sipas përmbajtjes së tij në kohën e depozitimit të rekursit.

18. Subjekti i interesuar, Gëzim Muça, ka prapësuar se arsyetimi i kufizuar i Gjykatës së Lartë për vendimet e mospranimit të rekursit është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese. Në kundërshtim nga sa pretendohet, kërkuesi ka ushtruar lirisht të gjitha të drejtat e tij si palë në gjykim, duke marrë përgjigje të arsyetuara nga gjykatat e faktit për pretendimet e parashtruara. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka vënë në diskutim çështje të ligjit, ndaj nuk kishte vend për zbatimin e nenit 473/a të KPC-së. Ajo ka analizuar vendimet e gjykatave të faktit, duke vlerësuar se ato kishin vepruar në përputhje me dispozitat e KC-së, duke mbajtur në konsideratë të drejtat që ai përfitonte sipas Ligjit për Legalizimin e Ndërtimeve pa Leje.

Trualli ishte i bashkuar me banesën e ndërtuar në të, duke formuar një send të vetëm, i cili nuk mund të ndahej.

19. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 50, datë 25.09.2025; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 30, datë 02.05.2025; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 76, datë 29.10.2024; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa ka pranuar se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsyetimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 23, datë 25.04.2023; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata ka theksuar gjithashtu se e drejta për t'u dëgjuar nuk konsiderohet e cenuar vetëm për shkak të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, për sa kohë që individi ka pasur mundësinë që të paraqesë pretendimet e tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, të cilat janë shqyrtuar nga kolegji i asaj gjykate në dhomën e këshillimit dhe, mbi këtë bazë, është vendosur mospranimi i rekursit (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 22, datë 06.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata ka vënë në dukje, po ashtu, se në shqyrtimin e ankimeve kushtetuese individuale ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 63, datë 23.10.2025; nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 67, datë 06.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata evidenton se në nenin 482, pika 1, të KPC-së ligjvënësi ka përcaktuar se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve, në dhomën e këshillimit, ndërsa shqyrtimi në seancë gjyqësore vendoset në rastet e parashikuara nga neni 482/a, pika 1, i po këtij kodi. Po kështu, sipas nenit 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitimin e parashtrësive të tyre për çështjet e ligjit.

23. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim nëse në rastin konkret Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji, ka marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara nga kërkuesi për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat më të ulëta, nëse ka vënë në diskutim kryesisht çështje të ligjit, si dhe nëse ka argumentuar mjaftueshëm qëndrimin e saj për mospranimin e rekursit.

24. Gjykata vëren se objekt i shqyrtimit në gjykatat e zakonshme ka qenë trualli mbi të cilin subjekti i interesuar, Gëzim Muça, ka rindërtuar banesën e dhuruar nga gjyshja. Ky truall ka qenë në bashkëpronësi të tij dhe xhaxhait të tij, në pjesët 2/3-at dhe 1/3-at secili, dhe është bërë objekt gjykimi në gjykatat e zakonshme, bazuar në kërkesëpadinë e paraqitur nga Gëzim Muça, i cili ka kërkuar njohjen e së drejtës së pronës mbi pjesën e truallit në pronësi të xhaxhait dhe kompensimin e këtij të fundit për pjesën e tij. Gjatë gjykimit, gjykata e rrethit ka vënë në dukje gjetjet e aktit të ekspertimit, sipas të cilit sipërfaqja objekt gjykimi ishte e zënë me ndërtimin e bërë nga paditësi, se i padituri nuk kishte pasur kundërshtime për këtë ndërtim, si dhe se ndërtimi ishte në proces legalizimi. Në kushtet kur trualli nuk mund të ndahej, për shkak të ndërtimit të bërë në të, në zbatim të nenit 207 të KC-së gjykata ka vlerësuar se pronësia e truallit duhej t'i njihej paditësit, i cili kishte detyrimin t'i paguante të paditurit pjesën e tij takuese në shumën 1.800.000 lekë, sipas vlerës së përcaktuar në aktin e ekspertimit.

25. Në ankimin e ushtruar ndaj këtij vendimi, Halim Muça ka pretenduar interpretimin arbitrar të ligjit nga gjykata e rrethit, me argumentin se trualli do të konsiderohej i zënë nëse ndërtimi do të ishte bërë me lejen e organit kompetent. Po sipas tij, në aktin e ekspertimit eksperti kishte pranuar se trualli mund të ndahej në natyrë dhe, sipas vendimit unifikues nr. 22, datë 13.03.2002 (*vendimi unifikues nr. 22/2002*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërtimi i realizuar në kundërshtim me normat në fuqi dhe i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme nuk mund të ishte objekt i pjesëtimit gjyqësor. Subjekti i interesuar, Gëzim Muça, ka kundërshtuar me kundërapel këto pretendime, duke prapësuar se akti i ekspertimit nuk pranonte se trualli mund të ndahej në natyrë, por ngrinte supozime nëse ai do

të ishte i lirë. Ndërkohë, trualli ishte i zënë me ndërtim në proces legalizimi. Po kështu, pretendimet për zbatimin e vendimit unifikues ishin të pabazuara, pasi ky vendim i referohej pjesëtimit të ndërtesave, ndërsa në rastin konkret kërkohej pjesëtimi i truallit.

26. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në prani të palëve, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke e gjetur atë në zbatim të drejtë të ligjit material e procedural. Sipas kësaj gjykate, në kundërshtim nga sa Halim Muça pretendonte, deri në vitin 1998 sendi objekt gjykimi kishte qenë i zënë me një ndërtim 1- katësh ku banonte Gëzim Muça me gjyshen e tij, ndërtim të cilin ai e kishte prishur me pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë, duke ndërtuar banesën 2-katëshe. Në kushtet kur sipas aktit të ekspertimit trualli nuk mund të pjesëtohej në natyrë, pasi ishte i zënë me ndërtimin pa leje, si dhe në rrethanat kur pretendimet ishin të njëjta me ato të ngritura gjatë gjyqimit të çështjes nga gjykata e shkallës së parë, për të cilat ankuesi kishte marrë përgjigje nga ajo gjykatë, vendimi i asaj gjykate duhej të lihej në fuqi.

27. Vendimi i gjykatës së apelit është kundërshtuar me rekurs nga shtetasi Halim Muça, i cili ka ndërruar jetë në datën 16.04.2020. Ndërsa në datën 13.12.2024 subjekti i interesuar, Gëzim Muça, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për përshejtimin e gjyqimit të çështjes, duke vënë në dispozicion të kësaj gjykate edhe certifikatën e datës 16.09.2020 të lëshuar nga ZVRPP-ja, Durrës, sipas së cilës trualli me sipërfaqe 310 m<sup>2</sup> dhe ndërtesa me sipërfaqe 273 m<sup>2</sup> rezultonin të regjistruara në emër të tij. Në përfundim të shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se gjykata e apelit kishte vepruar në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit material, duke analizuar dhe argumentuar mjaftueshëm për çështjen. Po sipas saj, gjatë gjyqimit, kërkuessit i ishte dhënë mundësia të paraqiste prova, të njëjhej me provat e palës kundërshtare, të debatonte për to, si dhe të shprehte opinionin e tij për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pa u vënë në kushte pabarazie e pa iu mohuar ndonjë e drejtë.

28. Në analizë të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se ajo gjykatë ka marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara nga kërkuessi në rekurs për interpretimin e zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e zakonshme përkundrejt qëndrimit të këtyre të fundit, se për shkak të ekzistencës së ndërtimit mbi të trualli nuk mund të ndahej në natyrë, ndaj për zgjidhjen e çështjes së pronësisë gjente zbatim neni 207 i KC-së, që përcaktonte pjesëtimin e sendit të përbashkët. Në përfundim të shqyrtimit të tij në dhomën e këshillimit, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë ligji, Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzionin se vendimi i gjykatës së apelit është dhënë në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit material, ndërsa nuk rezulton të ketë vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni. Në këtë

situatë, duke mbajtur në konsideratë se edhe gjykimi në gjykatat e faktit është zhvilluar në seancë gjyqësore me praninë e palëve, gjatë të cilave kërkuetit i është krijuar mundësia të marrë pjesë dhe të japë vlerësimin e tij për çështjet e ligjit, si dhe se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje përmes rekursit të tij, në të cilin ka parashtruar pretendimet për kundërshtimin e vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta, duke iu dhënë në këtë mënyrë e drejta për t'u shprehur dhe dëgjuar edhe përpara kësaj gjykate, Gjykata çmon se vetëm fakti i mospranimin të rekursit nuk është i mjaftueshëm në këndvështrimin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në drejtim të së drejtës së kërkuetit për akses substancial në atë gjykatë. Po kështu, arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë arbitrar në vlerësimin e shkaqeve të parashtruara nga kërkueti në rekurs dhe nuk vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

29. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të pabazuara.

30. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj ajo rrëzohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 26.03.2026**

**Shpallur më 05.06.2026**